UDHËZIM
Nr. 10, datë 6.5.2022

PËR NGRITJEN, FUNKSIONIMIN DHE ZHVILLIMIN PROFESIONAL TË RRJETIT KOMBËTAR TË MONITORUESVE, VLERËSUESVE DHE VLERËSUESVE ME BAZË RISKU PËR INSTITUCIONET ARSIMORE PARAUNIVERSITARE

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 26, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; të vendimit nr. 98, datë 27.2.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP)", dhe të vendimit nr. 99, datë 27.2.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar",

UDHËZOJ:

KREU I
NGRITJA E RRJETIT KOMBËTAR TË MONITORUESVE DHE VLERËSUESVE TË INSTITUCIONEVE ARSIMORE PARAUNIVERSITARE

Neni 1
Përcaktime paraprake

Në këtë udhëzim termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Monitorues" janë të gjithë nëpunësit e DPAP-së dhe DRAP-eve, me detyrë funksionale monitorimin e institucioneve arsimore parauniversitare, si dhe nëpunësit e ZVAP-ve dhe drejtuesit e IAP-ve të certifikuar si monitorues.
2. "Vlerësues" janë të gjithë nëpunësit e DPAP-së dhe DRAP-eve, me detyrë funksionale vlerësimin e institucioneve arsimore parauniversitare, si dhe nëpunësit e ZVAP-ve dhe drejtuesit e IAP-ve të certifikuar si vlerësues.
3. "Vlerësues me bazë risku", janë nëpunësit e ASCAP-it me detyrë funksionale vlerësimin me bazë risku, të veprimtarisë së institucionit përgjegjës për ofrimin e shërbimeve të arsimit parauniversitar dhe të institucioneve arsimore publike e private të sistemit të arsimit parauniversitar.
4. "Drejtues i institucionit arsimor" është drejtori ose nëndrejtori.

Neni 2
Qëllimi i Rrjetit Kombëtar të Monitoruesve dhe Vlerësuesve të IAP-ve

Qëllimi i krijimit të Rrjetit Kombëtar të Monitoruesve dhe Vlerësuesve është ngritja, funksionimi dhe fuqizimi i kapaciteteve monitoruese dhe vlerësuese në arsimin parauniversitar, nëpërmjet zhvillimit të vazhdueshëm profesional, shkëmbimit të informacionit, mbështetjes së ndërsjellë të eksperiencave të personalizuara dhe advokimit për ndryshime të procesit të sistemit të vlerësimit në fushën e arsimit parauniversitar.

Neni 3
Përgjegjësitë e ASCAP-it

1. ASCAP-i bashkëpunon me MAS-in, DPAP-në, DRAP-et, ZVAP-të dhe partnerë të tjerë për projektin "Rrjeti Kombëtar i Monitoruesve dhe Vlerësuesve të IAP-ve".

2. ASCAP-i zhvillon trajnimet me kandidatët e përzgjedhur për monitorues dhe vlerësues, dhe mbështet logjistikën e trajnimeve.

3. ASCAP-i në bashkëpunim me partnerë të tjerë, sipas marrëveshjeve të nënshkruara për këtë qëllim, përcakton metodologjinë e testimit dhe certifikimit në fund të programit të trajnimit dhe e realizon atë me të gjithë kandidatët për monitorues dhe vlerësues të IAP-ve.

Neni 4

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati për monitorues, dokumentacioni i aplikimit, afati dhe mënyra e dorëzimit të tij

1. Kandidati për monitorues i IAP-ve duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

a) të ketë të paktën 3 vjet përvojë të suksesshme në mësimdhënie, nga të cilat 1 vit përvojë si specialist në institucionet e arsimit parauniversitar;

b) të zotërojë diplomë të arsimit të lartë, të ciklit të dytë "Master i shkencave" ose të barasvlershme me të, në profilin mësuesi/shkenca edukimi, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë";

c) të ketë njohuri të mira të gjuhës angleze ose të një gjuhe tjetër të BE-së;

d) të përdorë efektivisht TIK-un;

e) të ketë marrë pjesë në trajnime për zhvillimin profesional;

f) të mos ketë masa disiplinore në fuqi ndaj tij.

2. Dokumentacioni i aplikimit për kandidatët për monitorues të IAP-ve përmban:

a) kërkesë në të cilin përshkruan detyrat sipas funksionit;

b) jetëshkrimin dhe kopjet e njësuara me origjinalin të dokumenteve që dëshmojnë pohimet në të;

c) kopjen e dokumentit të identitetit (ID);

d) vërtetim nga institucioni ku punon që nuk ka masë disiplinore në fuqi;

3. Dokumentacioni i aplikimit dorëzohet nëpërmjet shërbimit postar në ASCAP, brenda afatit kohor të shpallur në faqen zyrtare të ASCAP-it.

Neni 5

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati për vlerësues, dokumentacioni i aplikimit, afati dhe mënyra e dorëzimit të tij

1. Kandidati për vlerësues i IAP-ve duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

a) të ketë të paktën 5 vjet përvojë të suksesshme në mësimdhënie, nga të cilat 3 vjet përvojë të suksesshme në drejtimin e IAP-së ose 3 vjet përvojë si specialist në institucionet e arsimit parauniversitar;

b) të zotërojë diplomë të arsimit të lartë të ciklit të dytë "Master i shkencave" ose të barasvlershme me të, në profilin mësuesi/shkenca edukimi, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë";

c) të ketë fituar të paktën titullin "Mësues i kualifikuar", vlerësuar "Shumë mirë" ose "Shkëlqyeshëm";

d) mundësisht të ketë kryer trajnimin e detyrueshëm përgatitor pranë Shkollës së Drejtorëve, për drejtimin e institucionit arsimor parauniversitar dhe të jetë certifikuar;

e) të ketë njohuri të mira të gjuhës angleze ose të një gjuhe tjetër të BE-së;

f) të përdorë efektivisht TIK-un;

g) të ketë marrë pjesë në trajnime për zhvillimin profesional;

h) të mos ketë masa disiplinore në fuqi ndaj tij.

2. Dokumentacioni i aplikimit për kandidatët për vlerësues të IAP-ve përmban:

a) kërkesë në të cilin përshkruan detyrat sipas funksionit;

b) jetëshkrimin dhe kopjet e njësuara me origjinalin të dokumenteve që dëshmojnë pohimet në të;

c) kopjen e njësuar me origjinalin të librezës së punës;

d) kopjen e dokumentit të identitetit (ID);

e) certifikatën e drejtuesit të IAP-së (vetëm për drejtuesit e IAP-ve), të lëshuar nga CSL-ja;

f) vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore;

g) vërtetim nga institucioni ku punon që nuk ka masë disiplinore në fuqi;

h) certifikatat e trajnimeve;

i) letër rekomandimi nga eprori.

3. Dokumentacioni i aplikimit dorëzohet nëpërmjet shërbimit postar në ASCAP, brenda afatit kohor të shpallur në faqen zyrtare të ASCAP-it.

Neni 6

Komisioni i shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të aplikimit të kandidatëve për monitorues dhe vlerësues të IAP-ve

1. ASCAP-i ngre komisionin e shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të aplikimit të kandidatëve për monitorues dhe vlerësues të IAP-ve.

2. Komisioni përbëhet nga 5 anëtarë, përkatësisht:

a) titullari i ASCAP-it, i cili kryeson komisionin;

b) 1 përfaqësues i zgjedhur nga ASCAP-i;

c) 2 përfaqësues të zgjedhur nga DPAP-ja;

d) 1 përfaqësues i zgjedhur nga partnerët.

3. ASCAP-i mund të krijojë sipas rastit edhe më shumë se një komision.

4. Pas shqyrtimit të dokumentacionit, komisioni i vlerësimit rendit kandidatët në rendin zbritës dhe njofton kandidatët që kalojnë në fazën e trajnimit.

Neni 7

Programi i trajnimit të Rrjetit Kombëtar të Monitoruesve dhe Vlerësuesve të IAP-ve

1. Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar, me mbështetjen e partnerëve sipas marrëveshjeve, zhvillon programin e trajnimit të Rrjetit Kombëtar të Monitoruesve dhe Vlerësuesve të IAP-ve.

2. Temat e trajnimit, orët e trajnimit dhe si do të zhvillohet trajnimi përcaktohen nga një grup pune i përbërë nga ASCAP-i, DPAP-ja dhe partnerët.

3. Trajnimi zhvillohet në katër periudha kohore, ku në secilën prej periudhave trajnohen dhe certifikohen 100 monitorues dhe vlerësues.

4. Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar njofton kandidatët e përzgjedhur për trajnimin, datën, vendin/mjedisin dhe orarin e seancave të trajnimit.

Neni 8
Vlerësimi i kandidatëve për monitorues dhe vlerësues

1. Kandidati për monitorues dhe kandidati për vlerësues dorëzojnë portofolat e tyre, të cilët përmbajnë detyrat që ka kryer gjatë programit të trajnimit.
2. Kandidati për monitorues dhe vlerësues, në përfundim të trajnimit, i nënshtrohet testimit me shkrim në vendin dhe kohën e përcaktuar nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar.

Neni 9
Rezultatet e vlerësimit dhe ankimi

1. Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar njofton secilin prej kandidatëve për monitorues dhe vlerësues për rezultatin e vlerësimit.
2. Kandidatët për monitorues dhe vlerësues kanë të drejtë të ankohen me shkrim te titullari i Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, brenda pesë ditëve nga njoftimi i rezultateve, dhe të marrë përgjigje me shkrim prej tij, brenda dhjetë ditëve nga dorëzimi i ankesës.
3. Vendimi i Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar është përfundimtar.

Neni 10
Certifikimi i vlerësuesve të IAP-ve

1. Certifikata e trajnimit i jepet kandidatit për monitorues dhe vlerësues kur ai ka përmbushur detyrimet e përcaktuara në udhëzimin nr. 16, datë 28.7.2021, "Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë".
2. Certifikatat përgatiten nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, nënshkruhen nga titullari i saj dhe kanë vulën e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar.
3. ASCAP-i dërgon zyrtarisht në DPAP, DRAP-e dhe ZVAP listën e monitoruesve dhe vlerësuesve të certifikuar.

KREU II
FUNKSIONIMI I RRJETIT KOMBËTAR TË VLERËSUESVE TË IAP-ve

Neni 11
Përfshirja e monitoruesve dhe vlerësuesve në vlerësimin e IAP-ve

1. ASCAP-i, DPAP-ja dhe DRAP-et përfshijnë monitoruesit dhe vlerësuesit e certifikuar sipas nevojave dhe profileve të tyre në monitorimin dhe vlerësimin e institucioneve arsimore parauniversitare.
2. Pas miratimit nga titullarët e tyre, monitoruesit dhe vlerësuesit përfshihen në proceset e monitorimit dhe vlerësimit të institucioneve arsimore parauniversitare, duke hartuar raportet/informacionet përkatëse dhe paraqitur pranë titullarit të institucionit përgjegjës apo drejtuesit të grupit të ngarkuar me këtë detyrë.

Neni 12
Të drejtat e monitoruesve

Monitoruesit kanë të drejtë:

a) të monitorojnë përzgjedhjen, shpërndarjen dhe pajisjen e IAP-ve me tekste shkollore;

b) të monitorojnë kualifikimet e personelit mësimdhënës për kurrikulën, metodologjitë dhe standardet e përcaktuara nga institucioni përgjegjës;

c) të monitorojnë procesin e regjistrimit të fëmijëve/nxënësve në shkollë/kopsht;

d) të monitorojnë proceset e nismave të ndryshme të iniciuara nga MAS-i.

Neni 13

Detyrat e monitoruesve

Monitoruesit kanë për detyrë:

a) të marrin pjesë gjatë të gjithë kohës së planifikuar për monitorimin;

b) të deklarojnë konfliktin e interesit;

c) të bashkëpunojnë me anëtarët e tjerë të grupit të monitorimit;

d) të zbatojnë metodologjinë e përcaktuar në platformën e monitorimit;

e) të paraqesin çdo informacion, dokument dhe të japë çdo shpjegim për faktet e rrethanat e konstatuara dhe të nevojshme për monitorimin te drejtuesi i grupit të monitorimit apo titullari i institucionit përgjegjës;

f) të ruajnë konfidencialitetin e të dhënave;

g) të hartojnë informacionin/raportin e monitorimit dhe ta dorëzojnë atë te titullari i institucionit përgjegjës.

Neni 14

Të drejtat e vlerësuesve

Vlerësuesi ka të drejtë:

a) të vëzhgojë orë mësimore;

b) të zhvillojë me mësuesin përkatës analizën e orës mësimore të vëzhguar, bazuar në përshkruesit praktikë, sipas treguesve të cilësisë;

c) të kryejë fotografime apo regjistrime me mënyra a mjete të tjera teknike, të mjediseve, të dokumentacionit të IAP-së, të klasave etj., duke ruajtur konfidencialitetin e nxënësve, mësuesve dhe prindërve;

d) të shqyrtojë çdo dokument të nevojshëm për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore, përfshirë edhe dokumente të ruajtura, të krijuara apo të mbajtura në format elektronik;

e) të zhvillojë pyetësorë, anketa apo biseda me mësues, prindër, nxënës, duke ruajtur privatësinë e tyre;

f) të marrë pa pagesë dhe të përdor për qëllimet e vlerësimit çdo të dhënë të IAP-së dhe veprimtarisë së saj;

g) të administrojë çdo mjet tjetër prove, për përcaktimin e situatës/situatave faktike dhe rrethanave të nevojshme, për marrjen e një vendimi përfundimtar;

h) të komunikojë me punonjësit e IAP-së në mënyrë bashkëpunuese, të hapur, të qartë, etike dhe të çliruar nga çdo formë diskriminimi;

i) të krijojë marrëdhënie pune të bazuara në profesionalizëm dhe të mirëkuptojë çdo shqetësim apo rrethanë të veçantë të IAP-së.

Neni 15

Detyrat e vlerësuesve

Vlerësuesi ka për detyrë:

a) të marrë pjesë gjatë gjithë kohës së planifikuar për vlerësimin;

b) të deklarojë konfliktin e interesit;

c) të bashkëpunojë me anëtarët e tjerë të grupit të vlerësimit dhe të mospengojë kryerjen e veprimeve të vlerësimit;

d) të zbatojë metodologjinë e vlerësimit të përcaktuar në udhëzuesit zyrtarë;

e) të përdorë burimet e vlerësimit në mënyrë të dobishme, në funksion të përmbushjes së qëllimit;

f) të paraqesë çdo informacion, dokument dhe të japë çdo shpjegim për faktet e rrethanat e konstatuara dhe të nevojshme për vlerësimin te drejtuesi i grupit të vlerësimit;

g) të ruajë konfidencialitetin e të dhënave.

KREU III
ZHVILLIMI PROFESIONAL I RRJETIT TË MONITORUESVE DHE VLERËSUESVE TË IAP-ve

Neni 16
Zhvillimi profesional i vlerësuesve të IAP-ve

1. ASCAP-i identifikon nevojat për zhvillim profesional të monitoruesve dhe vlerësuesve të IAP-ve, dhe harton planin vjetor të veprimtarive për zhvillimin profesional të tyre, në përputhje me prioritetet e MAS-it dhe kuadrin ligjor në fuqi.

2. DPAP-ja mbështet ASCAP-in për zhvillimin profesional të monitoruesve dhe vlerësuesve, dhe për mbledhjen e të dhënave statistikore në sistemin e arsimit parauniversitar.

3. ASCAP-i zhvillon trajnime të drejtpërdrejta, *online* ose të kombinuara me Rrjetin Kombëtar të Monitoruesve dhe Vlerësuesve të IAP-ve në nivel DRAP-i, jo më pak se një herë në tre muaj.

4. ASCAP-i mentoron monitoruesit dhe vlerësuesit gjatë veprimtarisë monitoruese dhe vlerësuese për përmbushjen e detyrave funksionale të tyre. Mentorimi nga ASCAP-i mund të kryhet edhe me kërkesën e institucioneve vlerësuese.

5. ASCAP-i krijon një infrastrukturë digjitale (platformë digjitale) për zhvillimin potencial të monitoruesve dhe vlerësuese në vijimësi, në të cilën lidhen *online* monitoruesit dhe vlerësuesit, për të mundësuar të mësuarit e ndërsjellë, shkëmbimin e informacionit dhe mundësinë e trajnimeve të vazhdueshme.

KREU IV
VLERËSUESIT ME BAZË RISKU TË ASCAP-it

Neni 17
Detyrat e vlerësuesve me bazë risku të ASCAP-it

Vlerësuesit me bazë risku të ASCAP-it:

a) vlerësojnë dhe monitorojnë mbi bazë risku veprimtarinë e institucionit përgjegjës për ofrimin e shërbimeve të arsimit parauniversitar, për respektimin në vazhdimësi të kushteve dhe detyrimeve për ofrimin e shërbimit cilësor, shoqëruar me lënien e detyrave/sugjerimeve/rekomandimeve për përmirësimin e elementeve të caktuara të institucioneve apo gjithë sistemit të arsimit parauniversitar, si: kurrikul, standarde, metodologji, drejtim institucioni etj.;

b) vlerësojnë dhe monitorojnë mbi bazë risku veprimtarinë e institucioneve arsimore publike dhe private të sistemit të arsimit parauniversitar, për respektimin në vazhdimësi të kushteve dhe

detyrimeve për ofrimin e shërbimit cilësor, shoqëruar me lënien e detyrave/sugjerimeve/ rekomandimeve për përmirësimin e elementeve të caktuara të institucioneve apo të gjithë sistemit të arsimit parauniversitar, si: kurrikul, standarde, metodologji, drejtim institucioni etj.;

c) monitorojnë cilësinë e zbatimit të kurrikulës në lloje, nivele e cikle të ndryshme shkollimi;

d) këshillojnë dhe japin rekomandime për njësitë arsimore vendore përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe për institucionet arsimore parauniversitare, në lidhje me përmirësimin e cilësisë së shërbimit arsimor;

e) informojnë dhe raportojnë, nëpërmjet raporteve të vlerësimit të cilësisë, letrave informuese, komunikimit *online* dhe botimeve, ministrin përgjegjës për arsimin, institucionet e varësisë së ministrisë për arsimin, njësitë vendore arsimore, bashkitë që kanë nën juridiksion institucionet arsimore;

f) kontribuojnë në formulimin ose në rishikimin e politikave dhe të strategjive arsimore, si dhe në vendimmarrjet në fushën e reformave arsimore, mbi bazën e gjetjeve dhe informacioneve nga monitorimet dhe vlerësimet në bazë risku.

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 18
Dispozita të fundit

Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit dhe Sportit, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Evis Kushi